

Arsimi ne Himare
 Shkolla dhe situata e saj
 Detyra per te ardhmen

Drama demografike e krahines se Himares ne fillim te viteve 90 , besoj se ishte e pashoqe ne te gjithe Shqiperine . Mbi 80% e popullsisë emigroi . Ky vakum perfshiu edhe shkollat e Himares .Nga rreth 400 nxenes ne shkollat e mesme dhe 2000 nxenes ne te gjitha shkollat 8-vjecare nga Palasa ne Qeparo . Ne fillim te viteve 90 ky fluffier zbriti ne 350 nxenes ne shkollat 8-vjecare dhe 60 ne shkollen e mesme.


Por shpirti arsimdashës himarjot nuk vdiq. Ata qe ne shekuj dy gjera kane cmuar lirine dhe arsimin dhe kete here ditën 1'i mbajne shkollat hapur ,fale perkushtimit te personelit mesimor qe punoi ne keto vite si dhe i perkujdesjes se pushtetit vendor dhe te fondacionit SOfaS i cHi restauroi lokalet e shkollave sidomos ato 8-vjecare dhe te mesme te qytetit Himare. Nje kontribut te pacmuar ne kete drejtim ka dhene biri i Himares Vasillaq Zoto .Ne vitet 2000-2005 kemi nje rritje jo vetem te numrit te nxenesve par edhe te cilesise se punes se shkolles te cilat paraqiten ne tabelat e meposhtme.

Cila eshte gjendja e shkollave sot ne Himare .

Ekzistojne 1.Shkolla e mesme e pergjithshme Spiro Gjicknuri me 95 nxenes, personeli mesimor i kualifikuar ne lendet perkatese . Kushtet e lokalit te mira.

Tabela mbi numrin e nxenesve qe kane mbaruar maturen ne shkollen e mesme te Himares dhe vazhdojne shkollen e larte

Viti	nxenes ne mature	studente	%
0	7	3	43
1	9	5	45
2	12	5	42
3	8	5	63
4	13	7	77
5	18	11	67
gjithsej	67	39	58



Baza materiale mesimore mungon per lendet fizike, kimi, biologji ,gjuhe te huaj, gjeografi .Disponojme 12 komputera dhe nje biblioteke modeste .Inteneti mungon .

2. Shkolla 9-vjecare Spile me 270 nxenes .Shkolla relativisht e mirembajtur,personeli mesimor i kualifikuar (mungon mesuesi i histori -gjeografise)

3. Fshati Dhermi ka shkollë 9-vjecare me 54 nxenes. Kushtet e lokalit te mira, mungojne laboratoret dhe interneti.

Personeli mesimor jo plotesisht i kualifikuar.

4. Shkolla Vuno 9-vjecare (shkolle vartese)gjithsej 14 nxenes ne te dy ciklet. lapin mesim dy mesues .Gjendja e lokalit jo e mire.

5. Fshati Pilur s'ka shkollë ,gjithashtu edhe Palasa.

6. Fshati Qeparo ka shkollë 9-vjecare numri i nxenesve 45 ,gjendja e lokalit jo e mire. Personeli mesimor i reduktuar dhe jo plotesisht i kualifikuar. Mesimi zhvillohet ne klasa kolektive.

7. Fshati Kudhes cikli i ulet hen mesim me klasa kolektive me nje mesues per 4 klasa. Cikli i larte nje mesues per te kater klasat. Gjendja e lokalit jo e mire. Nxenes gjithsej 19 Personeli i pakualifikuar . Baza materiale e dobet.

Detyra per te ardhmen

Konceptet per shkollen sot kane ndryshuar ne shekullin e ri. Ky ndryshim si ne permbajtje dhe strukture kap shume sfera te shkolles ,pOT ne kete material duam te trajtojme disa prej tyre qe na duken me emergjente:

A . Perqendrimi i shkollave 9-vjecare(behet fjale per ciklin e larte vetem ne dy shkolla Dhermi e Spile)

Eshte i domosdoshem per keto arsye :


- Numri i vogel i nxenesve ne klasa nga 1-6 ne fshatrat Qeparo ,Kudhes, VullO con ne zhvillimin e mesimit ne klasa kolektive , pra ne uljen e cilesise dhe kohes se domosdoshme per te pervetesuar lenden mesimore. -Mungesa e mesuesve te specializuar con ne zhvilliminjo me cilesi te procesit mesimor .Moszhvillimi i gjuhes se huaj eshte nje tjeter faktor qe te con ne perqendrimin e nxenesve ne dy shkolla.

- Kostua ekonomike si ne kuadrin mesimor dhe mirembajten e godinave shkollore sot eshte i larte.

B. Krijimi i nje klime pozitive per shkollen

Arsimi dhe edukimi i nxenesve nuk behet vetem nga mesuesit dhe nuk duhet lene vetem ne doren e tyre. Koncepti i sotem per shkollen ka evoluar ndjeshem. Eksperienca skoceze per shkollen e perhapur ne mbi 21 shtete eshte furor edhe ne vendin tone nepermjet

fondacionit Soros . Esenca e kesaj eksperience eshte zbatimi i programit te Toni Bler :arsim, arsim, arsim. Kjo u zbatua ne parimin CraTe duhet here per te rritur cilesine e shkolles : nxenesit, prinderit, mesuesit, drejtori komuniteti, qeveria.



Hapja e sistemit te shkolles cvendos drejtorin nga froni duke e bere ate ingranazhin i cili ve ne levizje te gjitha hallkat e shkolles.

Bordi i shkolles eshte e vertete qe sipas ligjit ai duhet te ekzistoj ,por eksperience e deritanishme fiet per nje neglizhence aktive te tij.

Te gjithë duhet te kuptojme nje gje: ne shkolle nuk i behet ftese asnjërit . Te gjithë jemi te detyruar te shkojme si prinder, si biznes ,si komunitet . Menaxhimi i problemeve te shkolles nuk mood te behet vetem nga drejtori dhe personeli mesimor i saj.

Per sa thame me siper rekomandojme:

Perespektivat e zhvillimit ekonomik kerkojne qe ne Himare te hapet shkolle turizmi ne nivel rajonal. Nje ceshtje qe s'mund ta leme pa trajtuar eshte integrimi i te rinjve te ardhur nga zonat verilindore te vendit qe punojne ne Himare, te cilet bejne gjithë poeet ne bujqesi dhe tani ne turizem .Pergatitja profesionale e tyre eshte e ulet shumica jane me shkolle 8-vjecare . Ne i propozojme Bashkise Himare qe te negocioje me qeverine per hapjen e shkolles se mbremjes per kete kontigjent qytetar dhe per te rinjte vendas te cilet s 'kane patur mundesi te vazhdojne shkollen e mesme . Ne pamundesi per ngritjen e qendres komunitare per integrimin e tyre ,sepse keshtu japim nje shembull emancipimi evropian.

Problemin e shkolles se pare ne dy aspekte te saj (a) te filozofise nga e cila udhehiqet shkolla dhe (b)nga mjedisi i pooes se nxenesve. Problemi i filozofise se pooes ne shkolle e Shprehim Shkurt : cfare u mesojme nxenesve, si ua mesojme dhe sa jane ata te afte per te perballuar neser jeten. Ky problem nga njera ane eshte politika arsimore qe ka shteti, nga ana tjeter eshte roli vendimtar i personelit mesimor qe merret me edukimin dhe arsimimin e nxenesve.

Realizimi i mire i kesaj filozofie kerkon perkushtim shpirtëror, metodiko-didaktik e shkencor te mesuesve. Ne, mesuesit, te mos e shohim veten si rrogetare ne nje ekonomi

tregu, por si intelektuale largpames, si vazhdues te tradites se paraardhesve tane ne kushtet e reja per te perballuar sfida te reja.

Ne perfundim te problemeve qe neve na u duken me emergjente, ju ftojme te gjithëve te investoni per shkollen, sepse kur investoni per te keni investuar per te ardhmen tone, te ardhmen e HIMARES.

Pergatiti Leonidha Prifti